



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



02/ Nr. 6822
Data: 22.08.2025

**PROCESVERBAL I DËGJIMIT BUXHETOR I DEDIKUAR PËR OJQ DHE BIZNESE
PËR DRAFT BUXHETIN PËR VITIN 2026 DHE PARASHIKIMET PËR VITET 2027-
2028**

Procesverbali nga Dëgjimi i dytë Buxhetor në lidhje me Draft Buxhetin e Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2026 dhe parashikimi për vitet 2027-2028, të mbajtur me datën **11.08.2025**, duke filluar nga ora **10:00** në **Sallën e Takimeve**, në objektin e Komunës së Hanit të Elezit që gjendet në katin e I-rë, me gjithsej 12 pjesëmarrës/e, prej tyre 5 gra dhe 7 burra. Nga ekzekutivi, të pranishëm ishin Nënkryetari i Komunës së Hanit të Elezit, **z.Sevdi Dernjani**, Drejtoresha për Buxhet dhe Financa, **znj.Lindita Ballazhi**, si dhe nga Zyra e Kryetarit dhe disa nga drejtorët/et e drejtorive.

Takimin e kryesoi Nënkryetari i Komunës **z.Sevdi Dernjani**, i cili iu uroi mirëseardhje të pranishmëve, të cilët kishin gjetur kohë për të ardhur në dëgjimin buxhetor për prezentimin e draft buxhetit të Komunës Hanit të Elezit për vitin 2026, si dhe parashikimi për vitet 2027-2028, ku për rend të punës, kishte:

1. **Prezentimi i draft buxhetit të Komunës Hani i Elezit për vitin 2026 dhe parashikimi për vitet 2027-2028**
2. **Diskutimi**

Sevdi Dernjani thekson: Ky takim ka për qëllim që të marrim kërkesat dhe rekomandimet e juaja që mund t'i kontribuojnë shoqënisë për vitin 2026. Buxheti i komunës për vitin 2026 është 4.2 milion €, si dhe burimet e financimit të Komunës së Hanit të Elezit janë: Granti i Përgjithshëm, Granti specifik i arsimit, Granti specifik i shëndetësisë dhe Të Hyrat Vetanake. Për prezantim më të detajuar, do të ia japim fjalën drejtoreshës për Buxhet dhe Financa, znj.Lindita Ballazhi, e më pas do të kalohet tek ju për të shtruar diskutimin.

1. **Prezentimi i draft buxhetit të Komunës Hani i Elezit për vitin 2026 dhe parashikimi për vitet 2027-2028**

(Drejtoresha Lindita Ballazhi përshëndet dhe falënderon të pranishmit për pjesëmarrje në dëgjimin e dytë buxhetor e dedikuar për OJQ dhe biznese.)

Lindita Ballazhi thekson: Buxheti për vitin 2026 është 4,2 milion €, dhe këtë shumë totale e kemi nda nëpër kategori buxhetore, prej tyre e dedikuar për investime kapitale është shuma 891,140 €, pra në kuadër të kësaj shume ne mund të japim propozimet tona se çka dëshirojmë të

është edhe trotuari, e pse mos me u përfshi edhe kanalizimi? Unë kam bo edhe kërkesë me shkrim si administrator, por nuk po e shoh te kjo lista e projekteve dhe buxheti 10 mijë € po m'doket pak për këtë projekt.

Lindita Ballazhi: Me grupin punues për hartim të buxhetit do të kemi edhe disa takime, ku do të jenë edhe kryesuesi dhe asambleistat pjesë e atij takimi, dhe do të duhet t'i shikojmë të gjitha projektet me rend e sidomos financimin e tyre sepse Ministria më nuk na lejon me shuma të vogla, kështu që duhet që financimi i komplet këtyre projekteve të ndryshojë.

Igballe Bushi: Deshta me pyet drejtoreshën, për buxhetin që e keni nda për bizneset, pra a është vetëm për tregun apo ka edhe diçka tjetër?

Majlinda Kaloshi: Në këtë projekt përfshihet rregullimi i kësaj hapësirës mbrapa komunës është në procedurë të shpronësimit dhe aty planifikohet me u ndërtu tregu ditor, po ka me pas mundësi fleksibile që me lëviz në bazë të kërkesave që ka me i pas biznesi, shembull gjatë Panairit, mundet me u shfrytëzu qajo pjesë, ku ka me aps edhe një hapësirë që ka me u shfrytëzu edhe si rekreacion.

Igaballe Bushi: Te projekti për ndriçim publik, tek kjo pjesa kah kufini, pra prej te La Terrazza deri te kufini, gati që është terr, se shumë janë prish dritat, e problemi ma i amdh është kalimi i këmbësorëve prej fabrika tek Viva, ku nuk shihen këmbësorët kur ecin, nashta me e rrit pak kapacitetin e dritave në këto pjesë.

Amir Berisha: Isha ndërlidh te ky propozim, që te vendkalimet e këmbësorëve, te market Besa, te Viva e te tjerat, me u vendos disa shtylla ndriçuese, edhe janë t'mira me u pa, po edhe ka ndriçim ma shumë.

Sevdi Dernjani: Ne do t'i marrim të gjitha rekomandimet tuaja, do t'i shënojmë në procesverbal dhe do t'i shqyrtojmë. Sa për informacion, në mbledhjen e fundit të KKS-së, e kam obligu shefin e stacionit të policisë këtu me e bo një kërkesë te kryetari dhe më pas ne kërkesën e tyre me e dërgu te departamenti i rrugëve në infrastrukturë që me pas një bazë për rregullimin dhe sinjalizimin e rr.Adem Jashari dhe rr.11 Qershori sepse është rrugë magjistrale, megjithatë ku kemi ne hapësirë me intervenu si institucion lokal, pse jo. A ka edhe dikush diçka me shtu apo me plotësu? Nëse nuk ka, e shpall të mbyllur dëgjimin buxhetor.

Mbledhja përfundoi në ora 10:32.

Procesmbajtësja
Liridona Ballazhi

